



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr.19, datë 24/12/2024

PËR

**MIRATIMIN E LEJES “KËRKESË PËR KRYERJE SHPIMI
NËNTOKËSOR PËR NXJERRJE UJI (PUS-SHPIMI)”, SUBJEKTI
“AGJENCIA KOMBËTARE UJËSJELLËS-KANALIZIME”
(AKUK)**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar si dhe Vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Mat,

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për kryerje shpimi nëntokësor për nxjerrje uji (pus-shpimi) me qëllim furnizimin me ujë të Qytetit të Mamurrasit, subjekti “Agjencia Kombëtare Ujësjiellës-Kanalizime” (AKUK), me vendndodhje, Bashkia Kurbin, Qarku Lezhë, sipas këtyre koordinatave:
2. Treguesit janë si më poshtë:

Vendndodhja e përcaktuar për pus-shpimin

- X= 475778.2

- $Y= 4605504.8$
- $Z= 67$ m.m.n.d
- Sasia e ujit të kërkuar: $Q= 20-40$ l/s

- Thellësia e parashikuar = 50 m
- Diametri 1 (mm) 508 - Thellësia nga 0.00 m në 15.00 m
- Diametri 2 (mm) 355 - Thellësia nga 15.00 m në 50.00 m

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU MAT

GJERGJ PRENDE

